

në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Pllaqicë/Ploçica.

Burimet: deklarta S.M, FDH-33019; deklarta B.H, FDH-38180; deklarta S.M, FDH-15981; ICTY, IT-05-87 (Milutinović i dr), EX.6D00700, FDH-33284; J. Osmani, *Krimet...*, I, 539.

Hamëz (Riza) Morina

(17.02.1945, shqiptar nga Golluboci/
Golubovac, komuna e Malishevës/Mališevo,
bujk, pesë fëmijë)

Hamza jetonte me nëntë anëtarë të familjes së tij në *Mëhallën Morina*, në Golluboc/Golubovac. Të ardhurat i siguronin nga bujqësia dhe blegtoria. Gjatë vitit 1998, forcat serbe, të cilat ishin të stacionuara nëpër kodrat përmbi fshatin e Kijevës/Kijevo, disa herë e bombarduan Gollubocin/Golubovac. Në këto raste, familjarët e Hamzës e braktisnin fshatin. Në datën 25.09.1998, Hamza e strehoi familjen e vet në fshatin fqinj të Vuçakut/Vučak [Glllogoc/Glogovac]. Në mbrëmjen e datës **26.09.1998**, ai shkoi në **Golluboc/Golubovac**, për ta lëshuar bagëtinë në kullotë. Pas tri ditësh, djemtë e Hamzës, Enveri dhe Xhaferi, të brengosur me mungesën e të atit, u nisën për ta kërkuar atë. E gjetën trupin e tij në një kanal në pyllin e fshatit Golluboc/Golubovac. Në trupin e tij shiheshin në mënyrë të dukshme plagë, të prera thike dhe gjurmët e keqtrajtimit fizik. Po atë ditë, e kanë varrosur në një livadh të fshatit. Pas luftime, më 21.09.1999, familjarët e kanë riarrosur trupin e tij në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Pllaqicë/Ploçica.

Burimet: deklarata E.M, FDH-33018; deklarata V.B, FDH-8879; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284.

Riza (Riza) Maloku

(1931, shqiptar nga Pllaqica/Ploçica, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk, gjashtë fëmijë)

Në fillim të muajit gusht të vitit 1998, familja e Rizës e braktisi fshatin Pllaqicë/Ploçica dhe u strehua në pyllin e fshatit Golluboc/Golubovac. Në shtëpi mbetën vetëm Riza dhe bashkëshortja Vahidja. Kur më 25.09.1998, forcat serbe hyrën

në Pllaqicë/Ploçica, Riza dhe Vahidja e braktisën fshatin dhe iu bashkëngjitën familjes. Ditën e ardhshme [**26.09.1998**], ata vendosën që të ktheheshin në fshat [**Pllaqicë/Ploçica**]. Në oborrin e vet hasën në grupin e ushtarëve serb, të cilët menjëherë filluan ta keqtrajtonin fizikisht Rizën. Vahidja shpëtoi duke ikur me vrap. Pas tri ditësh, kur forcat serbe u larguan nga fshati, djemtë e Rizës u rikthyen në shtëpi. E gjetën trupin e pajetë të të atit në një vend afro 500 metra larg shtëpisë. Në trup i shiheshin qartë plagët nga plumbat. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Rizën në një livadh në pronësi të tyre. Pas luftime, më 29.09.2000, mbetjet mortore të Rizës janë riarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Pllaqicë/Ploçica.

Burimet: deklarata A.M, FDH-33619; deklarata V.B, FDH-8879; ICTY, IT-05-87 (Milutinović dhe të tjerë), EX.6D00700, FDH-33284; *Bodies of Six Killed Albanians Found near Ploçica Village on Tuesday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 07.10.1998, FDH-29726.

Ramiz (Mahmut) Hoxha

(10.12.1935, shqiptar nga Bellanica/Belanica, komuna e Malishevës/Mališevo, ndërmarrës privat, gjashtë fëmijë)

Gjatë ofensivës së parë të forcave serbe në muajin korrik të vitit 1998, Ramizi me familje kaluan në Bellanicë/Belanica. Qëndronin në një pyll, në afërsi të fshatit. Në fillim të muajit gusht u kthyen në shtëpi. Policia serbe ishte e stacionuar në fshatin fqinj të Banjës/Banja. Pas ftesës së policisë, shqiptarët e Bellanicës/Belanica shkuan në negociata me forcat serbe. Ramizi ishte në përbërje të delegacionit të fshatit. U arrit marrëveshja që policia nuk do ta sulmonte fshatin, nëse nuk hapej zjarr ndaj saj. Pas marrëveshjes, situata në fshat ishte e qetë për një muaj.

Në datën **2.10.1998**, Ramizi shkoi në xhami për ta kryer shërbesën e rregullt fetare [**Bellanicë/Belanica**]. Pas pak, në xhami erdhën katër pjesëtarë të maskuar të UÇK-së. E kërkonin imamin. Ramizi i pyeti përse po e kërkonin imamin dhe i mbanin maskat. Pas grindjes së shkurtër, ata e morën Ramizin jashtë dhe e futën